



Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republik of Kosovo

28-07-2023

01-110/05-994



Komuna e Vitise
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 14 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03L-040(Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008 në harmoni me nenin 6 paragrafi I, pika 1.2, neni 8 paragrafi I pika 1. 2 lidhur me neni 14, te Ligit me Nr. 06/L-092 për Dhenien ne Shfrytezim dhe Këmbim te Prones se Paluajtshme te Komunes (Gazeta Zyrtare Nr. 10, prill 2019), nenit 36 paragrafi 36.2 dhkronjs d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2023 merr kete:

V E N D I M

Për Plotësim Ndryshimin e Vendimit paraprak për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik me numer protokoli 01-110/05-657 të datës 30.06.2022 nga afatëshkurt në afatëgjatë.

Neni I

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës miraton plotësim ndryshimin e vendimit me numer protokoli 01-110/05-657 të datës 30.06.2022 për shkak që kanë kalur 1 vit pa u zhvilluar proceduar,dhe se ka të interesuar për investime mbi 1 milion euro,është paraqitur projekti investiv, të bëhet plotësim ndryshimi i vendimit nga afatëshkurt në afatëgjatë.

Neni II

Me kete vendim, Kuvendi i Komunës se Vitise miraton të ndryshohet vendimi paraprak per dhenien ne shfrytezim te prones se paluajtshme te Komunes se Vitise nga shfrytezimi afatshkurter personave fizik dhe juridik, në shfrytëzim agatëgjatë pasi që e lejon ligji si ne vijim:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00211-2, vendi i quajtur „ Visoça" me sipërfaqe prej 81412 m2;
2. Njesia kadastrale me n. P-70101018-00211-4, vendi i quajtur „ Visoça" me sipërfaqe prej 206276 m2.
3. Njesia kadastrale me nr. P-70101018-00098-0, vendi i quatur „Golesh” me sipërfaqe prej 771703 m2 ne zonën kadastrale ne Devaje. komuna e Vitise

Neni III

Afati kohore per dhenien ne shfrytezim te pronës se paluajtshme komunale nga afat shkurter të ndryshohet në afatëgjatë , me kultivimin e kulturave bujqësore, me qëllim te shfrytezimit nga ana e personave fizik apo juridik. Caktimi i afatit kohore për ndertimin e duhet te jetë: brenda nje viti duhet te filloj projekti pasi te shpallet fituesi.

Neni IV

Qellimi i dhënies ne shfrytezim te prones komunale eshte interesi publik dhe perfitimi ekonomik i komunes nga prona komunale.

Neni V

Procedurat per dhënien e prones se paluajtshme komunale ne shfrytëzim afatëgjatë realizohet permes

shprehjës së interesit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092 për Dhenien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunes.

Neni VI

Mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontrate, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të kryetarit të Komunes dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhë afatgjatë të shfrytëzimit, me të drejtë të shkeputjes së kontratës edhe para afatit, nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi

Neni VII

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjente dhe Drejtoria për Financa e Komunës së Vitisë.

Neni VIII

Ky vendim hyn fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullorës Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve komunale dhe pas publikimit në web faqën e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. Drejtorisë për Financa
3. Drejtorisë për Shërbime Publike
4. Drejtorisë për Administratë
5. Shërbimit të Kuvendit dhe
6. Arkivit

KUVENDI I KOMUNËS VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi


